

MIRË SE VINI NË ARSIMIN PARASHKOLLOR!

ARSIMI PARASHKOLLOR FILLON TË
ENJTEN MË 11.8.2022 DHE PËRFUNDON
TË PREMTEN MË 2.6.2023.



**Vantaa
Vanda**

MIRË SE VINI NË ARSIMIN PARASHKOLLOR!



Arsimi parashkollor fillon të enjten 11.8.2022 dhe përfundon të premten 2.6.2023.

Arsimi parashkollor është pjesë e rrugëtimit të përjetshëm mësimor, që fillon në shtëpi dhe në edukimin e hershëm dhe i cili vazhdon pas arsimit parashkollor në arsimin fillor. Qëllimi i arsimit parashkollor është që të promovohen kushtet e zhvillimit dhe arsimimit të fëmijës si dhe përforcimi i aftësive shoqërore të fëmijës dhe nevojës për besim ndaj vetëvetës së bashku me familjen. Arsimi parashkollor është i obligueshëm, i dëshiruar dhe i bazuar në programin mësimor. Secilit fëmijë i krijohet programi mësimor së bashku me fëmijën dhe prindërit e tij.

Në arsimin parashkollor fëmijët përjetojnë dhe mësojnë risi si pjesë e grupit të bashkëmoshatarëve. Arsimi parashkollor përbëhet nga pjesë mësimore të ndryshme dhe të realizuara në mënyra të ndryshme, të cilat bazohen në interesimin e fëmijës ndaj tyre si dhe nga qëllimi i përbashkët i arsimit parashkollor. Mësimi në

arsimin parashkollor në pjesën më të madhe zhvillohet përmes lojës, dhe për lojë çdo herë ka kohë gjatë orarit ditor të mësimit. Përveç lojës, eksperimentet e ndryshme dhe metodat funksionale të punës ofrojnë përvoja jetësore dhe përforcojnë motivin e fëmijëve për të mësuar.

Mos harro për të lajmëruar fëmijën tuaj në arsimin parashkollor më 5.1.-30.1.2022!

- Lajmërohu në shërbimin VaSa përmes internetit ose duke plotësuar formularin për konkurrim.
- Vendet e arsimit parashkollor në Vantaa mund të shihen në faqet e internetit: vantaa.fi/esiopetus
- Vendimi për pranim në arsimin parashkollor shikohet në VaSa në javën e 14.

Arsimi parashkollor është pa pagesë dhe përfshin edhe ushqimin

Arsimi parashkollor mbahet gjatë ditëve të shkollës, katër orë në ditë. Pjesëmarrja në arsimin parashkollor është pa pagesë dhe aty përfshihet edhe racioni ditor i ushqimit. Përveç arsimit parashkollor, fëmijët kanë mundësi të marrin pjesë edhe në arsimin parashkollor me pagesë si plotësim për edukimin e hershëm. Nevoja për edukimin e hershëm plotësues, lajmërohet së bashku me lajmërimin për arsimin parashkollor.

Mundësitë e zgjedhjes së gjuhëve në arsimin parashkollor

Në çdo grup të arsimit parashkollor, gjatë vitit, fëmijët do të njoftohen me gjuhën dhe kulturën e fëmijëve që i takojnë grupit. Nga gjuhët që i takojnë grupit do të mësohen disa nga fjalët më të zakonshme. Njohuria rreth familjeve si dhe gjuhëve dhe kulturave të tyre do të përdoret në planifikimin dhe realizimin e arsimit parashkollor.

Nëse dëshironi që për fëmijën tuaj të zgjedhni një drejtim më të përforcuar gjuhësor, në Vantaa ka mundësi për të konkurruar:

- në arsimin parashkollor me gjuhën angleze të theksuar

- në arsimin parashkollor në gjuhën suedeze apo
- në arsimin parashkollor me përqëndrim në gjuhën angleze

Më shumë të dhëna rreth zgjedhjes së gjuhës: vantaa.fi/kaksikielinenesiopetus

Bashkëpunimi me shkollën

Gjatë kohës së viteve të arsimit parashkollor, fëmija njihet me kulturën e veprimit të shkollës dhe me mjedisin ku mësohet. Në Vantaa, secili vend parashkollor ka një shkollë si partner bashkëpunimi, me të cilën bëhen veprime të përbashkëta funksionale. Kjo do të thotë p.sh. aktivitetë i përbashkët për fëmijë në arsimin parashkollor dhe fëmijë në arsimin fillor si dhe vizita nëpër shkolla. Gjatë gjysëmvetorit pranveror nga mësimi parashkollor, të dhënat lidhur me fëmijën barten në shkollën e ardhëshme të tij në bashkëpunim me prindërit. Qëllimi i kësaj është që fëmijës t'i sigurohet një vazhdimësi nga niveli parashkollor në shkollën fillore si dhe një mbështetje fillestare për vazhdimin e shkollimit

Mirë se vini për t'u njoftuar!

Në të gjitha qerdhet në Vantaa që ofrojnë mësimin parashkollor organizohen takime njoftuese për familjet gjatë javës së 20-të. Qerdhet i njoftojnë prindërit për takimet.

Pregatitje për të mësuar në gjuhën finlandeze përmes mësimin përgatitor në arsimin fillestar

Mësimi përgatitor për fillimin e arsimit fillor ju organizohet atyre fëmijëve me prejardhje si emigrantë, të cilët nuk e njohin mjaftueshëm gjuhën finlandeze për të qenë pjesëmarrës në grupin e arsimit parashkollor.

Mësimi përgatitor për fillimin e arsimit fillor organizohet gjatë ditëve të shkollës nga pesë orë në ditë. Katër orë mësimi janë si pjesë e mësimin parashkollor dhe një orë mësimi organizohet në grup më të vogël.

Prindërit e lajmërojnë fëmijën në arsimin parashkollor, dhe pas kësaj mundësia e pjesëmarrjes në mësimin përgatitor për arsimin fillor bëhet në marrëveshje bashkëpunimi mes prindërve të fëmijës, vendit të arsimit parashkollor si dhe koordinitorit për gjuhë dhe kulturë.



**Vantaa
Vanda**